UDHËZIM
Nr.9, datë 15.3.2010

PËR PROCEDURAT DHE AFATET E RISHPËRNDARJES SË BONOVE TË INVESTUARA NË FONDET E INVESTIMEVE, TË KRIJUARA NË PËRPUTHJE ME LIGJIN NR.7979, DATË 26.7.1995 "PËR FONDET E INVESTIMEVE"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të paragrafit të katërt të nenit 137 të ligjit nr.10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Rishpërndarja e bonove të privatizimit dhe të letrave të të përndjekurve, të investuara në fondet e investimeve, të krijuara në përputhje me ligjin nr.7979, datë 26.7.1995 "Për fondet e investimeve", do të kryhet pranë bankave të nivelit të dytë që kanë shërbyer si banka depozitare të fondit përkatës.

2. Procesi i rishpërndarjes do të fillojë në datën 1 prill 2010 dhe do të mbyllet në 30 shtator 2010.

3. Për të përmbushur procedurat e rikthimit të bonove të investuara, bankat e nivelit të dytë do të aplikojnë tarifat e shërbimit, sipas vendimit të organeve të veta vendimmarrëse.

4. Individët që kanë investuar në fondet e investimit, të krijuara në përputhje me pikën 1 të këtij udhëzimi e që dëshirojnë të rimarrin mbrapsht bonin/bonot e investuar/investuara, duhet të paraqesin pranë sporteleve të bankës përkatëse për t'i tërhequr ato. Dokumentet identifikuese dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm përcaktohet nga banka.

5. Kthimi i bonos/bonove do të bëhet në vlerën e investuar sipas listave emërore të zotëruara nga banka depozitare.

6. Në përfundim të afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, banka depozitare paraqet raportin me shkrim pranë Ministrit të Financave, në lidhje me sasinë e rishpërndarë të bonove, si dhe sasinë e mbetur pa shpërndarë. Procedura e asgjësimit të bonove të mbetura, do të rregullohet me një akt të veçantë, në përputhje me legjislacionin e fushës.

7. Në rast se individi që ka investuar në fondin e investimit, rezulton i vdekur, kthimi mbrapsht i bonos/bonove të depozituara do të bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë trashëgiminë.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode